




**Memorandum Mirëkuptimi
në mes të
Zyrës së Këshillit të Europës në Prishtinë
dhe
Komunës së Gjakovës**



Qëllimi dhe fusha

Ky Memorandum Mirëkuptimi (MM) vendos bashkëpunimin në mes të programit rajonal të Këshillit të Europës për "Promovimin e qeverisjen e mirë dhe fuqizimin e komuniteti Romë në nivel vendor" (ROMACTED) dhe Komunës së Gjakovës në kuadër të zbatimit të Programit ROMACTED. ROMACTED është një nismë e përbashkët midis Bashkimit Europian (DG NEAR) dhe Këshillit të Europës, zbatuar në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi.

Duke njohur rolin vendimtar të autoriteteve vendore për zhvillim dhe për të sjellë përmirësimin real për qytetarët duke përfshirë Romë në fushat prioritare kyçe të arsimit, punësimit dhe mirëqenies sociale, shëndetësisë, strehimit dhe promovimit kulturor sipas kompetencave të tyre;

Palët e përfshira në këtë MM bien dakord që të bashkëpunojnë për fuqizimin Romë, në këtë mënyrë për të kontribuar në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planeve dhe projekteve për to.

Detyrimet e partnerëve

Partnerët njohin rolet dhe detyrimet e tyre përkatëse, në linjë me kuadrin e caktuar ligjor/statutor dhe bien dakord për të punuar së bashku nën frymën e vërtetë të partneritetit dhe nën dritën e parimeve të Kuadrit të BE-së për Integrimin Romë, prioritetet kombëtare dhe vendore për përfshirjen sociale të Romëve.

Partnerët do të:

- angazhohen për të nxitur bashkëpunimin, mekanizmat e komunikimit të rregullt, shkëmbim të informacionit dhe përditësimin e aktiviteteve përkatëse;
- bien dakord për të mbajtur takime vjetore për të shkëmbyer pikëpamjet mbi aspektet e zhvillimit dhe zbatimit të programit ROMACTED.

Ekipi i Këshillit të Europës do të:



- në përputhje me rolin e saj për të ofruar bashkëpunim të bazuar në standarde, do të sigurojë mbështetje dhe dukshmëri në pjesëmarrjen e qeverive lokale të synuara në programin ROMACTED;



- komunikojë me publikun në lidhje me vendimmarrjen për të zbatuar programin ROMACTED, duke e përfshirë në faqen e internetit, veçanërisht duke vendosur logon ROMACTED dhe një link të faqes së internetit të programit ROMACTED;
- sigurojë pjesëmarrjen e stafit në departamentet përkatëse të komunës në lidhje me aktivitetet e ngritjes së kapaciteteve të planifikuara në kuadër të procesit ROMACTED;
- kontribuojë në hartimin ose përditësimin e Planeve Lokale të Veprimit për Përfshirjen e Romëve, me kontributin e Grupeve Lokale të Veprimit, të ngritura me mbështetjen e Programit ROMACTED dhe sigurojë aprovimin e Planit prej autoriteteve lokal;
- kërkojë të integrojë, ku nevojitet, përmbajtjen e Planit Lokal të Veprimit për Përfshirjen e Romëve në Strategjinë e Përgjithshme të Zhvillimit Lokal dhe Planit të komunës;
- kërkojë të zbatojë Planin Lokal të Veprimit për Përfshirjen e Romëve, përfshirë aktivitetet e integruara në Strategjinë e Zhvillimit Lokal dhe Planin Lokal, duke financuar burime vendore, si dhe duke kërkuar, ku nevojitet, financim të jashtëm, si fondet e BE-së.

Hyrja në Fuqi

Ky MM do të hyjë në fuqi mbas nënshkrimit prej të gjitha palëve përgjatë kohëzgjatjes së zbatimit të programit, prej Marsit 2018 deri në 30 prill 2020. Ky MM mund të përfundojë nëse kjo kërkohej prej palëve me shkrim.

Në emër të programit ROMACTED:  znj Isabelle Servoz-Gallucci Shefja e Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë Data: 31/05/2018 	Ne emër të Komunës së Gjakovës:  z. Ardian Kryetari Komunës së Gjakovës  Data: _____
--	---